



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:086041
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06360782

Ac.nr.880/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Adnan Konushevcu dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses J.I. nga fshati J., Komuna e Shterpçës, kundër të paditurës Komuna Shterpce, të cilën me autorizim e përfaqëson D.V. avokat nga Shterpca, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të së paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shterpce, C.nr.96/2021, të datës 28.09.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Komuna Shterpce dhe NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shterpce, C.nr.96/2021, të datës 28.09.2021, dhe çështja vendoset si vijon: REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditëses J.I. nga fshati J., Komuna e Shterpçës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna Shterpce që paditëses t'ia paguaj kompensimin në emër të shpenzimeve të ushqimit shumpn prej 1.210,00 euro, për periudhën nga data 22.04.2018 deri 01.04.2021, nga dy (2) euro për çdo ditë të punës, së bashku me kamatën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shterpce, C.nr.96/2021, të datës 28.09.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

“I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.J. nga fshati J., Komuna e Shterpçës, dhe OBLIGOHET e paditura Komuna Shterpce që paditëses t'ia paguaj kompensimin në emër të shpenzimeve të ushqimit shumpn prej 1.210,00 euro, për periudhën nga data

22.04.2018 deri 01.04.2021, nga dy (2) euro për çdo ditë të punës, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parshtrimit të padisë 22.04.2021, deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET si e pabazar kërkesëpadia e paditëses përtej asaj të gjykJaur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e punës t'ia paguaj edhe shumë prej 180 euro, për periudhën nga 01.01.2018 deri 22.04.2018, për shkak të parashkrimit të kërkesës monetare, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parshtrimit të padisë 22.04.2021, deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 euro në afat prej shtatë ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit”.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës, aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe të refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Shtërpçës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që lidhur me kompensimin e ushqimit ditor, nga 01.01.2018 deri 22.04.2021, për 695 ditë pune, nga 2 (dy) euro në ditë, t'ia paguaj shumë prej 1,390.00 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerr me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes së fakteve dhe aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të karakterit procedural të rëndësisë esenciale të cilat e bëjnë që çështja të rivlerësohet nga aspekti i themelit sërish në shkallë të parë me rishqyrtim, por ka gjetur se mbi gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, plotësisht gabimisht është zbatuar e drejta materiale me rastin e detyrimit të të paditurës si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, andaj kolegji i kësaj gjykate ka gjetur se aktgjykimi i atakuar duhet të

ndryshohet në mënyrë që i njëjti të përliqjet me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale mbështetur në gjendjen e fakteve dhe provave që përbëjnë themelësinë faktike të çështjes.

Kolegji vlerëson se në rastin e tillë kërkesa e paditëses nuk gjen mbështetje në dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, për arsye se e njëjta ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe se e njëjta ka qenë në fuqi deri me datë 31.12.2017, ndaj dhe duke qenë se ajo ka skaduar së implementuari nga kjo datë (31.12.2017 pas denoncimit të saj nga partneri social i punëdhënësit Oda Ekonomike), e njëjta është e pazbatueshme në rastin e paditëses për kërkesën e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga data 01.01.2018 deri 01.04.2021, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 54 të MPKK-së.

Paditësja padinë e ka paraqitur me datë 22.04.2021, dhe në këtë rast nuk mund të aplikoheshin dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive përkitazi me njohjen e të drejtave të paditëses për shpërblimet e kërkuara në emër të shujtave ditore, sepse në kohën kur paditësja ka paraqitur padinë, për shkak të mungesës së bazës ligjore respektivisht se MKK ka pushuar së vlejuri, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur me datë 11.06.2018 dhe e nënshkruar nga organizatat e të punësuarve ka pasur shtrirje kohore deri me datë 10.06.2021, në bazë të së cilës paditësja do të mund të realizonte të drejtat e saja nga kjo Kontratë, në asnjë dispozitë të saj nuk e ka paraparë kompensimin e shujtave ditore, ashtu siç ishte e përcaktuar me dispozitën e nenit 54 të MKK-së, ndaj dhe në situatën e tillë është dashur që kërkesa e paditëses të refuzohej në tërësi si e pabazuar, për shkak se e drejta subjektive e pretenduar me padi nuk ka gëzuar mbrojtje juridike, për arsye se padia e paditëses është paraqitur jashtë afatit ligjor, sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, ndërsa paditësja padinë e ka paraqitur më datë 22.04.2021, duke kaluar afatin prej 3 viteve për realizimin e kësaj kërkesë, që njehe rit krahas asaj se kërkesëpadia e paditëses për kompensim të shpërblimit për ushqim ditor nuk ka bazë ligjore është edhe kërkesë e parashkruar që parashihet në nenin 87 të Ligjit të Punës, për të cilat arsye është dashur që kërkesëpadia e paditëses të refuzohej në tërësi si e pabazuar.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën II të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Andaj, për arsyet e dhëna si më sipër e mbështetur në nenin 195 pika (e) lidhur me nenin 201 pika (d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.880/2022, me datë 28.10.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v